

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË ÇËSHTJA KOLA KUNDËR SHQIPËRISË (Kërkesa nr. 70656/17)

VENDIM

STRASBURG
13 qershor 2023

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen Kola kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komision i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

duke pasur në konsideratë:

kërkesën (nr. 70656/17) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34, të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), më 21 shtator 2017, nga një shtetas shqiptar, z. Ndrec Kola, lindur në vitin 1962 dhe banues në Tiranë ("kërkuesi"), i cili u përfaqësua nga z. T. Prendi, një avokat që e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare ("Qeveria") për ankesat, në lidhje me të drejtën e kërkuesit për t'u gjykuar në praninë e tij dhe të drejtën e tij për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuar nga ish-Agjentja e saj znj. A. Hicka, dhe në vijim nga z. O. Moçka, nga Avokatura e Shtetit, dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më datë 23 maj 2023,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkuesi u gjykua në mungesë për akuzat e vrasjes dhe mbajtjen pa leje të armëve të zjarrit nga Gjykata e Rrethit Tiranë. Më 11 dhjetor 2012, ai u shpall fajtor për këto akuza dhe u dënua me nëntëmbëdhjetë vite burgim.

2. Pasi kërkuesi u arrestua në Greqi dhe u ekstradua në Shqipëri, ai depozitoi një apelim kundër dënimit të tij, duke argumentuar se, edhe pse ai nuk kishte dijeni për procedurat penale kundër tij, ai ishte gjykuar në mungesë. Dënimi i tij mbështetej në deklaratat e dhëna nga katër dëshmitarë - deklaratat të dhëna gjatë hetimit - të cilët ishin marrë në pyetje vetëm nga prokuroria dhe nuk kishin dhënë dëshmi në gjyq.

3. Më 12 mars 2015, Gjykata e Apelit Tiranë zhvilloi një seancë, gjatë së cilës kërkuesi ishte i pranishëm. Në atë seancë nuk u paraqitën prova dhe Gjykata e Apelit e rrëzoi kërkesën e kërkuesit që të dëgjoheshin dëshmitarët, dhe la në fuqi vendimin e datës 11 dhjetor 2012, duke argumentuar se fajësia e kërkuesit ishte provuar me anë të një kontrolli në vendin e ngjarjes, ekspertizës mjeko-ligjore, ekspertizës balistike, procesverbalit për sekuestrimin e provave materiale dhe deklaratave të katër dëshmitarëve të tjerë të dhëna gjatë gjykimit, si edhe mbështetur në deklaratat e dëshmitarëve dhënë gjatë hetimit. Vendndodhja e këtyre dëshmitarëve ishte bërë me dije gjatë gjykimit.

4. Në apelin e tij të mëpasshëm depozituar pranë Gjykatës së Lartë, kërkuesi kërkoi që vendimet e Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë të prisheshin dhe të jepej

urdhër për rigjykim. Kërkuesi pretendoi se ishte shkelur e drejta e tij për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në gjykim, sipas nenit 6 të Konventës, pasi ai nuk kishte marrë pjesë në gjykim dhe nuk kishte dijeni për të.

5. Gjykata e Lartë e rrëzoi apelimin e kërkuesit më 28 janar 2016. Më 22 prill 2016, vendimi i Gjykatës së Lartë iu dha kërkuesit, mbështetur në kërkesën e tij.

6. Më 8 nëntor 2016, ligji nr. 99/2016 u publikua në Fletoren Zyrtare. Ai shkurtonte afatin për depozitim të një ankese kushtetuese nga dy vite në katër muaj: “nga konstatimi i cenimit [i të drejtës ose lirisë kushtetuese]”. Gjithashtu, ky ligj parashikonte se afati i ri do të hynte në fuqi më 1 mars 2017.

7. Më 8 mars 2017, kërkuesi kërkoi përsëri që t'i jepej vendimi i Gjykatës së Lartë. Me anë të një shkresë të datës 16 mars 2017, Gjykata e Lartë informoi kërkuesin përsëri se e kishte rrëzuar apelimin e tij më 28 janar 2016.

8. Kërkuesi depozitoi një ankesë kushtetuese më 10 maj 2017, ku kërkonte që vendimet e gjykatave më të ulëta të prisheshin dhe që të lejohej kërkesa e tij për rigjykim përpara gjykatës së shkallës së parë. Ai pretendonte, për sa ka të bëjë me pretendimet e tij përpara Gjykatës, se ishte shkelur:

- E drejta për t'u vetëmbrojtur, sepse gjykimi në gjykatën e shkallës së parë ishte zhvilluar në mungesë të tij dhe pa praninë e avokatit të zgjedhur prej tij;

- E drejta për t'u dëgjuar, sepse edhe pse ai kishte qenë i pranishëm në procesin përpara gjykatës së apelit, nuk i ishte dhënë mundësia t'i drejtonte pyetje dëshmitarëve ose të kontestonte provat kundër tij;

- E drejta për një vendim të arsyetuar, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit nuk kishin dhënë arsyet e duhura për vendimet e tyre dhe nuk kishin marrë në konsideratë provat në favor të tij.

Në këtë mënyrë, ai pretendonte se ishte shkelur e drejta e tij për një gjykim të drejtë, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës.

9. Më 4 korrik 2017, Gjykata Kushtetuese e deklaroi ankesën kushtetuese të kërkuesit të papranueshme pasi ishte depozituar përtej periudhës katërmujore.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR AKSES NË GJYKATËN KUSHTETUESE

10. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35 §§ 3 (a) të Konventës, apo e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

11. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese sipas afatit të ri katërmujor për dorëzimin e një ankese kushtetuese janë përmbledhur në vendimin *Çela kundër Shqipërisë*, nr. 73274/17, §§ 20, 27–29 dhe 32, 29 nëntor 2022.

12. Në çështjen konkrete, vendimi i formës së prerë nga Gjykata Kushtetuese u miratua më 28 janar 2016, iu ofrua kërkuesit më 22 prill 2016 dhe ankesa kushtetuese e kërkuesit ndaj atij vendimi u depozitua më 10 maj 2017. Kjo kërkesë u deklarua e papranueshme pasi ishte depozituar përtej afatit të ri katërmujor.

13. Gjykata tashmë kishte gjykuar në një situatë të ngjashme se zbatimi i afatit të ri katërmujor për depozitim të një ankese kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, për vendimet e miratuara përpara datës 1 mars 2017, ishte në shkelje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Ajo gjykonte se në periudhën kur kërkuesi kishte depozituar ankesën e tij kushtetuese, interpretimi më i rreptë i miratuar nga Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderohej si një veprim që krijonte praktikë gjyqësore, gjë për të cilën kërkuesi duhet të kishte pasur dijeni (shih, *Çela*, cituar më sipër, §§ 37 dhe 40). Gjykata nuk sheh asnjë arsye që të gjykojë ndryshe në çështjen konkrete, pasi kërkuesi e depozitoi ankesën e tij kushtetuese më 10 maj 2017, kur pozicioni i Gjykatës Kushtetuese se zbatimi i një afati të ri katërmujor do të zbatohet për vendimet e Gjykatës së Lartë të miratuara përpara datës 1 mars 2017 nuk ishte përcaktuar ende qartazi. Në lidhje me këtë gjë, Gjykata vëren se pavarësisht nëse afati dyvjeçar do të llogaritej nga

data kur ishte miratuar vendimi i Gjykatës së Lartë apo nga data kur ky vendim i ishte dhënë kërkuessit, kërkuessi e kishte respektuar atë afat.

14. Për këtë arsye, ishte shkelur neni 6 § 1 i Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuessit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtuese.

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 §§ 1 DHE 3(C) TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN E KËRKUESIT PËR TË MARRË PJESË NË PROCESIN PENAL NDAJ TIJ

15. Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 6 të Konventës, pasi mënyra në të cilën Gjykata Kushtetuese kishte interpretuar afatin për depozitim të një ankese kushtetuese e privonte kërkuessin nga e drejta për t'iu drejtuar asaj gjykate. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese nuk i shqyrtoi meritat e ankesës kushtetuese të kërkuessit në të cilat ai pretendonte se ishte shkelur neni 6 i Konventës, për arsye se nuk kishte pasur një mundësi efektive për të paraqitur dhe kundërshtuar provat, për t'iu drejtuar pyetje dëshmitarit dhe për t'iu përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur prej tij (shih paragrafin 7 më sipër).

16. Në lidhje me gjykimin e saj për të drejtën e kërkuessit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 6 § 1 të Konventës (shih paragrafin 14 më sipër), Gjykata vëren se kërkuessi tashmë ka një mundësi të kërkojë rihapjen e procesit përpara asaj gjykate (shih paragrafin 19 më poshtë). Kjo e fundit do të krijonte mundësinë për një shqyrtim të ankesave të tjera të kërkuessit sipas Konventës. Gjykata nuk mund të spekulojë se cilat do të ishin rezultatet e këtyre procedurave. Në këto rrethana, Gjykata është e mendimit se pjesa tjetër e ankesave të kërkuessit është e parakohshme dhe duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës (shih, *mutatis mutandis*, *Baljak dhe të Tjerët kundër Kroacisë*, nr. 41295/19, §§ 45-46).

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

17. Kërkuessi kërkojë 30,000 euro për dëmin jopasuror dhe 6,200 euro për kostot dhe shpenzimet përpara Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës.

18. Qeveria i vlerësoi shumat e pretenduara të pambështetura në fakte dhe të tepërta.

19. Gjykata përsërit se një vendim tek i cili ajo konstaton një shkelje e vendos Shtetin përgjegjës përpara detyrimit ligjor që ta ndërpresë shkeljen dhe të rregullojë pasojat. Duke pasur parasysh natyrën e ankesës së kërkuessit dhe të shkeljes së konstatuar, Gjykata gjykon se forma më e përshtatshme për korrigjim në çështjen konkrete do të ishte rihapja e procesit në Gjykatën Kushtetuese, nëse kërkuessi do ta kërkojë një gjë të tillë, pasi ajo ka mundësi që të ofrojë *restitutio in integrum*, sipas parashikimit të nenit 41 të Konventës (krahaso *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 77–79, 10 maj 2011 dhe *X kundër Holandës*, nr. 72631/17, § 61, 27 korrik 2021). Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se neni 71/c i ligjit për funksionimin dhe organizimin e Gjykatës Kushtetuese parashikon se procesi përpara Gjykatës Kushtetuese mund të rihapet nëse një gjykatë ndërkombëtare me juridiksion detyrues ndaj Republikës së Shqipërisë konstaton se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të një individi “për shkak të një vendimi [të mëparshëm] të Gjykatës Kushtetuese”. Në këtë mënyrë, konstatimi i një shkelje përbën kompensim të drejtë të mjaftueshëm në çështjen konkrete.

20. Në lidhje me dokumentet në zotërimin e saj, Gjykata e mendon të arsyeshme të akordojë 3,000 euro për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuessit.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. E shpall ankesën në lidhje me të drejtën e kërkuessit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese të pranueshme, dhe vendos se ankesat e tjera janë të papranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës;

3. Gjykon se konstatimi i një shkelje përmban në vetvete mjaftueshëm kompensim të drejtë për dëmin jopasuror të përballuar nga kërkuessi;

4. Gjykon:

a) se Shteti përgjegjës duhet t'i paguajë kërkuetit, brenda tre muajve, 3,000 euro (tre mijë euro) për kostot dhe shpenzimet, që duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit përgjegjës në normën e zbatuar në datën e shlyerjes plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuetit;

b) se që nga përfundimi i periudhës tremujore përmendur më sipër deri në shlyerjen e shumës, interesi i thjeshtë do të paguhet për këtë shumë në normën e barabartë me normën marginale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes së pagesës plus tre për qind pikë;

5. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuetit për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 13 qershor 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3, të Rregullores së Gjykatës.

Georgios A. Serghides
KRYETAR

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE